



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** **Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)**

- **Nga:** **Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës**

- **Datë:** **12 prill 2023**
- **Lënda:** **RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 1 janar – 31 mars 2023**

Gjykata Supreme e Kosovës në tremujorin e parë të vitit 2023 ka përfunduar 406 lëndë, derisa të pakryera rezultojnë 216 lëndë.


Nga 622 lëndë në punë gjatë periudhës raportuese, janë pranuar 421 lëndë të reja, ndërkaq të trashëguara nga viti 2022 kanë qenë 201 lëndë.

Muaji prill e ka gjetur Gjykatën Supreme me 216 lëndë të pakryera, në të cilat, numrin më të madh e përbëjnë revizionet – R - me 111 lëndë të pakryera, pasuar nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë - PML me 44 sosh dhe Kërkesat për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm Administrativ me 24 lëndë të pakryera.

Në këtë numër përfshihen edhe 20 kërkesa të pakryera për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit - PZD.

Shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve 96.43 për qind


Numri i lëndëve të kryera në raport me numrin e lëndëve të pakryera, në këtë tre mujor, i kalkuluar në përqindje, jep këtë pasqyrë në grafikun:



1. Numri i lëndëve të kryera dhe atyre të pakryera,, shprehur në përqindje

Ndërkaq, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, e kalkuluar në përqindje, është 96.43 për qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.

Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe, që përfshijnë, 151 revizione (Rev), 117 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë - PML, 48 kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm administrativ-ARJ, 32 kërkesa për zbutje të jashtëzakonshëm të dënimit - PZD., etj..



2.Lëndët e kryera, sipas kërkesave të pranuar

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, Gjykata Supreme ka përfunduar edhe;

13 lëndë, civile të ndryshme CN

12 revizione ekonomike E.Rev.

9 ankesa administrative AA

8 revizione administrative A.Rev.

7 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë civile CML

3 ankesa për paraburgime PN.II

3 kërkesa mbrojtje e ligjshmërisë, kundërvajtje KML

2 kërkesa administrative të ndryshme AN dhe

1 kërkesë përsëritje e procedurës civile CPP

Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, në periudhën raportuese, përkatësisht me datë 27 shkurt 2023, ka mbajtur një Seancë të Përgjithshme¹ të të gjithë gjyqtarëve të saj, përfshirë gjyqtarët e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nën drejtimin e u.d. Kryetares së Gjykatës Supreme, Mejreme Memaj.

Në këtë seancë, janë miratuar

Dy (2) mendime juridike dhe

Tre (3) udhëzues.

Mendimet juridike të miratuara janë:

- Mendimi Juridik lidhur me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publikë: drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave;
- Mendimi juridik për shpërblimin jubilar, lidhur me ligjin e aplikueshëm, marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar;

Bazuar në kompetencat e saj ligjore, në këtë Seancë, gjyqtarët e Gjykatës Supreme kanë miratuar edhe tre udhëzues:

- Udhëzuesi Juridik lidhur me ligjin e aplikueshëm: Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.04/L-034, lidhur me çështjen se a duhet pezulluar procedura përmbarimore kundër ndërmarrjes dhe asetëve të saj që është subjekt i vendimit për likuidim, lidhur me kërkesat monetare, apo duhet vazhduar procedura gjyqësore përmbarimore lidhur me kërkesat e tilla monetare pavarësisht që ndërmarrja kundër të cilës zhvillohet kjo procedurë gjyqësore përmbarimore ndodhet në procedurë të likuidimit.
- Udhëzuesi lidhur me konfliktet administrative të iniciuara nga Shoqëritë Tregtare kundër vendimeve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative, për të cilat Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar; dhe

¹ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2023/02/27/mbahet-seanca-e-pergjithshme-e-gjykates-supreme-miratohen-dy-mendime-juridike-dhe-tre-udhezues/>

- Udhëzuesi për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo-material.



Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme, 27 shkurt 2023

Mendimet juridike² dhe udhëzuesit³ e miratuar janë publikuar në ueb-faqen e gjykatës në të dy versionet, në gjuhën shqipe dhe në atë serbe.

² <https://supreme.gjyqesori-rks.org/mendimet-juridike/>

³ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/korniza-ligjore/udhezimet-administrative/udhezimet/>

Puna e Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore

- Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore i Gjykatës Supreme, ka mbajtur një takim gjatë muajit shkurt, në të cilin është diskutuar lidhur me procesin e revidimit të Udhëzuesit të Përgjithshëm për Politikë Ndëshkimore, pas ndryshimeve të bëra konform Kodit të Ri Penal dhe atij të Procedurës Penale.

Puna e Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 - 2025, si dhe Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 - 2024

-Komisioni për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 - 2025, si dhe Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 - 2024 ka mbajtur dy takime në këtë tremujor të parë të vitit 2023.

Në takimin e parë kanë marrë pjesë ekspertët britanik David Wells dhe Quentin Oliver, të angazhuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilët kanë përpiluar një plan veprimi për këtë Komision.


Anëtarët e Komisionit, përveç monitorimit dhe vlerësimit, do të japin edhe rekomandime lidhur me implementimin e strategjisë.

Plani Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022 - 2024, është miratuar para vitit 2022, ndërkohë që monitorimi i zbatimit të tij ka filluar në tetor të vitit 2022, pasi KGjK, themeloi Komisionin e përbërë nga Afrim Shala, kryetar dhe Mejreme Mema, Milena Djeric; Rrustem Thaqi dhe Ragip Namani, anëtarë.

Komisioni ka mbajtur edhe një takim online me datë 18 prill 2023, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të KoSEJ III, nga Këshilli i Evropës në Prishtinë, lidhur me adresimin e çështjes së lëndëve të pazgjidhura në gjykata.

Publikimi i vendimeve gjyqësore

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2023, Gjykata Supreme ka publikuar 768 aktgjykime dhe aktvendime⁴, prej tyre 487 vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.



4. Gjatë tremujorit të I-rë, janë publikuar 768 vendime

⁴ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

PËR PERIUdhËN 1.03.2023 DERI MË 31.03.2023

	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "PA"	0	0	0	0	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	20	141	161	117	44
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	5	47	52	32	20
Revizion "Rev" "Rev II"	137	125	262	151	111
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	9	1	10	7	3
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	0	1	1	1	0
Civile të ndryshme "CN"	2	11	13	13	0
Revizione ekonomike "E.Rev"	14	6	20	12	8
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	0	0	0	0	0
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmerise administrative "AML"	0	0	0	0	0
A.Rev.	0	9	9	8	1
ARJ	10	62	72	48	24
Ankesa administrative "AA"	3	10	13	9	4
Mbrojtje e ligjshmerise kundervajtje "KML"	1	2	3	3	0
Ankesa per paraburgime "PN.II"	0	3	3	3	0
Penale Ndhme Juridike Nderkombetare "PNJD"	0	0	0	0	0
Administrative të ndryshme "AN"	0	3	3	2	1
Gjithsej	201	421	622	406	216